



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1213 Prot.

Tiranë, më 06 09.2022

THIRRJE

**PËR PARAQITJEN E SHPREHJES SË INTERESIT NGA PROKURORËT PËR
ANËTAR NË KËSHILLIN DREJTUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

Në kushtet e vendit vakant të një anëtari prokuror në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 247, pika 1, shkronja “d” dhe pika 2 e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Prokurori i Përgjithshëm shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për prokurorët që duan të kandidojnë si anëtar në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Kandidatët që shprehin interesin duhet të jenë prokurorë me përvojë dhe nuk mund të jenë njëkohësisht anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Njoftohen të gjithë prokurorët që dëshirojnë të kandidojnë, që kanë **15 ditë** kohë të shprehin interesin e tyre përmes një kërkesë me shkrim ose me email në adresën elektronike info@pp.gov.al;

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA

